



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2186/3 prot.

Pukë, më 22 .12 .2025

PROCESVERBAL I MBLEDHJES Së KËSHILLIT BASHKIAK PUKË
date 19 .12 .2025

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3, shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe në zbatim të vendimit të kryesisë së këshillit nr. 7 datë 12.12.2025, mbledhja e radhës e këshillit Bashkiak Pukë u zhvillua me datën **19.12.2025**, ora **13⁻³⁰** tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend - dite :

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 17.10.2025
2. Projekt-vendim : Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Shtator** 2025.
3. Projekt-vendim : Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Tetor** 2025.
4. Projekt-vendim : "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026"
5. Projekt-vendim : "Per procedurat e prioriteteve për investime e shërbime për vitin 2026"
6. Projekt-vendim : "Për trajtimin me bursë të nxënësve të akomoduar në konviktin "Ali Bytyçi" për vitin shkollor 2025-2026.
7. Projekt-vendim : "Për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2025-2026"
8. Projekt-vendim : "Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin 2026"

9. Relacion shpjegues dhe informues ” Mbi raportin e performancës së Bashkisë Pukë për vitin 2024”

10. Të tjera.

Ne mbledhje moren pjese: Rrok Dodaj , kryetari i Bashkise, Lavdie Terbuni, pergjegjese e zyres sociale , Sokol Gjoni , drejtor i burimeve njerezore, Fiqirete Latifi. Drejtore e Finances,

Mbledhja filloi ne oren 13:³⁰ . Jane prezent ne mbledhje 13 keshilltarë , pra eshte koorumi i domosdoshem per fillimin e mbledhjes. Por dy keshilltar jane larguar ne oren 14:50.

Kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka hapi mbledhjen dhe prezantoi projekt-rendin e dites te miratuar nga kryesia po keshtu dhe dy kerkesa nga Bashkia per t'i shtuar ne rendin e dites:

1. Projekt-vendim ” Per numrin e pergjithshem te punonjesve te Bashkise Puke per vitin 2026”
2. Projekt-vendim : Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Nentor** 2025.

Pas diskutimit te anetareve, u hodh ne votim dhe u miratua rendi i dites , se bashku me shtesat , me **13** vota pro, 0 , vota kunder, 0 vota abstenim.

1. Mbledhja vijoi me **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 17.10.2025**

U hodh ne votim dhe u miratua **procesverbali i mbledhjes së dates 17.10.2025** me **13** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Shtator** 2025.

Pyetje : Gjon Gjoka: A ka ndryshim 6% e fondit?

Sqaron : Lavdie Terbuni: 6% te fondit nuk ka ndryshime.

U hodh ne votim dhe u miratua dhënia e ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Shtator** 2025, me **13** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

3. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Tetor** 2025.

Pyetje : Gjon Gjoka: A ka ndryshim 6% e fondit?

Sqaron : Lavdie Terbuni: 6% te fondit nuk ka ndryshime.

U hodh ne votim dhe u miratua dhënia e ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Tetor** 2025. me **13** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

4. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Nentor** 2025.

Pyetje : Gjon Gjoka: A ka ndryshim 6% e fondit?

Sqaron : Lavdie Terbuni: 6% te fondit nuk ka ndryshime. ◀

U hodh ne votim dhe u miratua dhënia e ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Nentor** 2025. me **13** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

(Me kekesen e keshillit Projekti per Buxhetin dhe numrin e punonjeve u la per t'i diskutuar ne fund)

5. Projekt-vendim : “Per procedurat e prioriteteve për investime e shërbime për vitin 2026”

Diskutime:

Aleksander Frroku: Ka mjaft ndryshime dhe pune te bera, ndricimi eshte bere ne disa fshatra ka disa fshatra qe duhet plotesuar me proiritete kryesishte ne shkoze, ura , rruga e Tejfanit dhe ura, rrethimi i varrezave etj.

Gjon Gjoka : Varrezat e Korthpules.

Ndue Lalaj : Jane proritet per investime : Çezma publike ne qender te Gjegjanit.Per urat te merren masa per t'i riparuar, te rruga e fshatit Dom te behet nje investim. Per Jazet e vijave kemi nevoje per tuba dhe materiale te tjera. Kemi nevoje per nje eskavator per njesine Gjegjan.

Arben Guga : Rruga per ne majen e Murges , Rruga qe lidh liqenin te permiresohet dhe Rruga e Dedajve.

Shpresa Pemaj: ne rrugen e Qerret po demtohet asfalti, shtrimi me cakull i pjeseve te tjera. Fasada e shkolles se mesme Puke duhet te bere sa me shpejte qe te jete e mundur.

Rrok Dodaj: Jane te drejta kerkesat tuaja , por besoj eshte nje lapsur , por do te plotesohen te gjitha prioritet per te qene gati . Kam fut sallen e leksioneve te Pallatit te Kultures me ba rikonstruksion me keshillin e Qarkut.

Per Majen e Murges e kemi fut si prioritet dhe me ndertu ballkone panoramike do te jete projekt qe do te miratohet me Turizmin. Jemi per zhvillimin e Pukes dhe bashkepunojme me cilindo per ta permiresuar Puken. Edhe ne Kukaj do ta bejme ndricimin.

Besmira Aliaj: Rruga dhe kanalet nuk pastrohen . Ka rreshqitje dherash. Ndricimi, pastrimi i rruges dhe kanaleve dhe nje kosh mbeturinash ne fund te rruges te liqeni.

Gjon Gjoka : Rruga e Kaftalles eshte riparuar.

Arben Guga : Na duhet nje fadrome per Qelzen.

Rrok Dodaj: Do t'i plotesojme prioritetet.

Gjon Gjoka : Ne Gjegjan eshte punuar me shume.

Ndue Lalaj: Ne Kimez te plotesohen prioritetet , Mulliri ne Kimez nuk eshte vene ne pune. Nuk ka uje ne shtepija, duhet investim.

D. Asani : Lista e prioriteteve eshte prej 5 viteve , por duhet me i realizu.

Falenderoj Keshillin e Qarkut per investimin te varrezat dhe te Pallati i Kultures.

Ka shume probleme ne qytet dhe nuk jane ne liste prioritetesh, si Pallati i termetit, por eshte lene pa bere pallati perball shkolles, kur jane bere pallatet e tjera dhe nuk eshte ne prioritate.Kena investu te ZIP LINE dhe nuk eshte ne pune. Qeleza ka disa prioritate, por te rikonstruksioni i liqenit ne Midhe nuk dime se cfare mund te behet , ka rruge , ura qe mungojne.

Rrok Dodaj: Per qytetin ne i kemi te perfshira te rikualifikimi urban. Ato do te behen me fondin e zhvillimit., Fasadat i kemi te perfshira te gjitha , kemi bere vetem 5 pallatet ne hyrje dhe do te vazhdojme ne vijim. Per ne Qelez kemi planifikuar 4 ura ,kanali vadites ne Bushat , Shoze , Gojane me Ministrine e Bujqesise. Ne prioritate i fusim te gjitha dhe kur te mundemi me gjet investim. Nuk jane selektive.

Ndue Lalaj : Kerkohet vend depozitim mbetjesh ne Gjegjan.

Rrok Dodaj: Kjo do te jete e varur nga Qeveria, ndryshon strategjia.

Tre kosha mbeturinash te ura e kalivares, kerkes e nje qytetari nga Kalivarja , prezent ne mbledhje.

Rrok Dodaj: Mbeturinat e minieres nuk mund te hidhen ne koshat e Bashkise, pasi ka edhe mbeturina toksike.

Gjon Gjoka: Nese jane toksike nuk do te kete kosha.

Enver Sulejmani: Jane dakord qe te gjita te jene ne prioritete. Kryetari te bashkepunoje me qeverine per realizimin e projekteve. Qeveria kerkon projekte, te konkurohet me projekte. Ky eshte bashkepunimi.

Rrok Dodaj: Niveli i pagave do te jete per ne Janar me hyrjen ne fuqi te ndryshimit te pages minimale.

U hodh ne votim dhe u miratua projekt-vendim : "Per proçedurat e prioriteteve për investime e shërbime për vitin 2026" me **13** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

6. Projekt-vendim : "Për trajtimin me bursë të nxënësve të akomoduar në konviktin "Ali Bytyçi" për vitin shkollor 2025-2026.

Pyetje : Gj. Gjoka: A mbulohen me burse te gjithe nxenesit?

Sqaron Sokol Gjoni : Te gjithe pa perjashtim.

U hodh ne votim dhe u miratua projekt-vendimi : Për trajtimin me bursë të nxënësve të akomoduar në konviktin "Ali Bytyçi" për vitin shkollor 2025-2026. me **13** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

7. Projekt-vendim : "Për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2025-2026

Pyetje: Gj. Gjoka : Sa eshte plani i bursave?

Sqaron Sokol Gjoni : 15 bursa eshte plani , ne kemi 9 kerkesa per burse.

U hodh ne votim dhe u miratua projekt-vendimi : Për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2025-2026. me **13** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

8. Projekt-vendim : "Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin 2026"

Sqaron Kryetari i keshillit : A ka detajim ne buxhet per keshillin?

F. Latifi: Jane te detajuara : udhetime, trajnime , shpenzime etj.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekt-vendimi Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin 2026. me **13** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

9. Relacion shpjegues dhe informues ” Mbi raportin e performancës së Bashkisë Pukë për vitin 2024”

Sqaron Sokol Gjoni : U sqarua keshilli per planin e performances se Bashkise per vitin 2024.

Kjo ishte thjesht per informimin e keshillit.

10.Projekt-vendim : “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026”

Pyetje: Enver Sulejmani : A ka rritje buxheti per te perballuar minimumin e pagave?

F. Latifi: 8% eshte rritja e buxhetit.

Dritan Asani: Sa eshte % e investimeve?

F. Latifi: 6% eshte investime dhe 17% jane shpenzime, ku futen dhe sherbimet

D. Asani Cfare eshte menduar te futet te 6% investime?

F. Latifi: Bashkefinancimi per shkollen Migjeni (20% e investimit , qe zgjat tre vite dhe Bashkia ka detyrim bashkefinancimi) dhe Blerje paisje sipas tabelës nr.3.

Rrok Dodaj: Ka edhe bashkefinancime te tjera dhe duhen buxhete.

Sqaron : Fiqirete Latifi: Pas kalimit te fazave te tjera bazuar ne ligj kemi hartuar projekt-buxhetin ne vijim sqaron te dhenat e paraqitura ne te gjitha tabelat e projekt-vendimit. Rritja eshte 8% me shume buxhet , 14% te ardhurat, 49% transferta grand, 37% tranferta sektoriale.

D. Asani : Nuk ka ardhur per miratim paketa fiskale.

F.Latifi: Niveli i te ardhurave eshte i njejte si ne vitin e kaluar , pasi niveli i taksave eshte i njejte pa ndryshime.

Gjon Gjoka : Taksat i referohen vitit 2023, per vitin 2024, me ndonje ndryshim te vogel ne vitin 2025 sivjet nuk ka ndryshime per vitin 2026.

E. Sulejmani : Duhet te kishte ardhur paketa fiskale, qofte edhe pa ndryshime.

D. Asani: Te mblidhemi pas 5 ditesh dhe t'i miratojme te dyja edhe buxhetin dhe paketen fiskale.

B. Aliaj: Ne si keshilltar duhet te kishim nje relacion informues per nderhyrjet , qe jane bere gjate vitit 2025

Rr. Dodaj: Keni te drejte dhe mund ta kerkoni informacionin.

F. Latifi: Informacionin mund t'ua sjellim pasi te mbyllet buxheti, ne mbledhjen e ardhshme jua sjellin listen e te gjitha objekteve ku eshte nderhyre gjate vitit 2025

Rrok Dodaj: Per vitin ne vijim do te kemi nderhyrje te salla e leksioneve me financim nga keshilli i Qarkut dhe kerkohet bashkefinancim nga Bashkia , po keshtu dhe kur marrim baze materiale per t'i vene ne pune duhen shpenzime per sherbime.

U hodh ne votim dhe u miratua projekt-vendimi : Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2026-2028 dhe buxhetin vjetor për vitin 2026“ me **11** vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

11.Projekt-vendim ” Per numrin e pergjithshem te punonjesve te Bashkise Puke per vitin 2026”

Pyetje: Gj. Gjoka : cfare ke thene me shkurtimine disa vendeve te punes.

Sqaron Sokol Gjoni : 357 punonjes gjithsej vitin e kaluar. Tani jane 350 punonjes Grupi i punes ka nzjerr 7 pozicione vakante, 3 jane audit te licensuar dhe nuk kemi persona qe e perbushin kete pozicion, 2 ne sherbimin pyjor dhe 2 specialiste ne turizem.

Rrok Dodaj: Jane struktura vakante, nuk eshte larguar askush nga puna.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekt-vendimi Per numrin e pergjithshem te punonjesve te Bashkise Puke per vitin 2026 me 11 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

Enver Dabjini



Goan Gokor
Haxhi

Arben Guga


Dhritan Asani



Aleksander Troku


Shpresa Temuj



Abdurekoll Mehmet

Lete Kolaj
Alban Lelm.


Besim Kaci


sekretari i bashkisë
Haxhi Teubani
